



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

**V E N D I M**

**Nr. 15 Datë 10.04.2017**

**“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ GERTI” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 51, nenit 52, të ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika f, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “ Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike , që nuk janë objekt konçesioni”, miratimin paraprak Nr. 4398/3, datë 20.10.2016 të MEI, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor të subjektit “**GERTI**” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

**V e n d o s i:**

1-Miratimin e kërkesës së subjektit “**GERTI sh.p.k.**” me administrator Z. JETON DANI, për përdorim të burimit ujor **Përroi i Tuçepit**, për prodhim energjie elektrike, në Njësinë Administrative Ostren , Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti HEC JETON do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes: X- 44 58 972.4; Y - 45 91 367.5; Z - + 580 m

Koordinatat e godinës së centrali: X -44 57 855.1; Y - 45 95 210.5; Z - + 493 m;

Koordinatat e pikës së shkarkimit : X -44 57 855.1; Y -45 95 210.5; Z - + 493 m;

Prurja mesatare e burimit ujor:  $Q_{mes} = 1.12 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti:  $Q \text{ llog} = 1.75 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja ekologjike  $Q_{ekol} = 0.197 \text{ m}^3/\text{sek}$ ;

Prurja që shkarkohet:  $Q = 1.75 \text{ m}^3/\text{sek}$ .

2-Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

**PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË**

**SEKRETAR**

**Martin PLLUMBI**

**KRYETAR**

**Paulin RADOVANI**

